Kronikë

Atentat në Shkodër, i riu ekzekutohet me breshëri kallashi në makinë! 1 vit më parë u kthye nga Belgjika! Dyshohet për 2 qitës (EMRI+VIDEO)

*33-vjeçari Ramazan Mataj u ekzekutua me breshëri kallashi brenda në makinë. Dyshohet se u vra mbrëmë, por sot **u gjet i pajetë nga banorët e zonës.** Dyshohet për 2 qitës, pasi ka shenja plumbash në dy anët e makinës. Babai thotë se s'kanë konflikte, ndërsa i riu para 1 viti u kthye nga Belgjika.*

- Babai: U rrit pa bukë e me vështirësi, s'kemi konflikte
- VIDEO/ Makina e bërë shoshë nga plumbat! I riu u qëllua nga të dyja anët e mjetit
- I afërmi: S'ka pasur konflikte, punoi në ndërtim në Mal të Zi
- Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes! Ja 'Benz'-i me të cili udhëtonte i riu
- Del FOTO, ja kush është i riu që u ekzekutua me breshëri plumbash në Shkodër

Redaksia
5 Janar, 08:07 | **Përditesimi: 5 Janar, 14:12**

Share

SHKODËR- Një i riu u ekzekutua në Shkodër në një antenat mafioz në zonën e Dragoçit, teksa ishte duke shkuar me makinë në shtëpi. 33-vjeçari u vra me breshëri kallashi rreth një vit pasi ishte kthyer nga Belgjika në vendin tonë.

Ngjarja dyshohet se ka ndodhur mbrëmjen e 4 janarit 2025, ndërsa i riu Ramazan Mataj ishte në makinë kur e zunë në pritë dhe ndaj tij u derdhën breshëri plumbash. Ai është gjetur i pajetë mëngjesin e sotëm, 5 janar, nga banorët e zonës brenda në makinë, të cilët më pas kanë njoftuar edhe policinë.

Disa banorë pranë zonës ku ndodhi atentati kanë dëshmuar që kanë dëgjuar zhurmë si të shtëna, por kanë menduar se janë fishekzjarrë dhe nuk i kanë kushtuar rëndësi. Kjo pasi në këtë zonë ndodhet edhe një lokal që organizon dasma.

LEXO EDHE:
I vranë të birin në Shkodër, flet babai: U rrit pa bukë e me vështirësi, s'ka pasur konflikte

Atentati shënon edhe ngjarjen e parë kriminale me viktimë, për vitin 2025. Mataj mori shumë plumba në pjesën e sipërme të trupit, pasi është qëlluar me breshëri kallashnikovi. Kjo dëshmohet edhe përmes pamjeve që Report Tv siguroi nga vendi i ngjarjes, ku në dy anët e makinës dallohen shenjat e plumbave që janë derdhur në drejtim të të riut.

Kjo ka shtuar dyshimet e grupit hetimor se kemi të bëjmë me të paktën 2 qitës, por nuk përjashtohet as mundësia e autorëve të tjerë që mund t'i kenë ndihmuar në largimin nga vendi i ngjarjes. Në zonë nuk ka kamera sigurie për të parë nga janë larguar dhe pritet të kontrollohen kamera në distancë, por mbetet e vështirë që policia të bie në gjurmët e tyre.

33-vjeçar Mataj, vetëm pak para ngjarjes kishte njoftuar babanë se po kthehej në shtëpi, ndërsa 58-vjeçari Fatmir Mataj, mes dhimbjes mohon që i biri të ketë pasur probleme. Ai shton se fëmijët i ka rritur me vështirësi financiare.

> *"Nuk e di arsyen e vrasjes. Djali im nuk ka patur asnjë problem me persona të tjerë dhe asnjë konflikt. Ne nuk jemi në dijeni të asnjë konflikti. Djali im është rritur pa bukë dhe me shumë vështirësi. Nuk ka qenë aspak person problematik", thotë babai.*

Përveç Belgjikës 33-vjeçari Ramazan Mataj ka jetuar edhe në Itali, teksa vitin e fundit punonte mes Greqisë dhe Malit të Zi në punë sezonale, ndërsa të afërmit thonë se një vëlla e ka ende në Belgjikë.

> *"Më parë ka jetuar në Belgjikë, ka një vit e ca. Ka punuar edhe në Mal të Zi. S'ka shprehur asnjë shqetësim. Unë jo, por këtu njerëzit i kanë dëgjuar krismat. Apelin e kemi për policinë, nuk na la të shohim as kufomën. Ne s'kemi pasur konflikt me askënd, e kanë gjetur kalimtarët. Ka 3 fëmijë, dy djem e një vajzë. Kushtet i ka pasur të këqija, u rritën u futën në punë. Edhe vëllai tjetër është në Belgjikë", tregon Naim Mataj.*

Arsyet janë ende të paqarta për grupin hetimor, pasi viktima Mataj dhe familja e tij

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com nuk njihen si problematikë në zonë. Madje, i vetmi procedim penal ndaj 33-vjeçarit rezulton për prerje të paligjshme të pyjeve. Pistat e hetimit janë fokusuar edhe tek konfliktet që i riu mund të jetë pasur jashtë vendit.

Raportojnë për Report Tv dhe Shqiptarja.com, gazetarët Ergys Kavaja dhe Sokol Dema



Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:46

Atentati në Shkodër, flet i afërmi i të riut: S'ka pasur konflikte, erdhi nga Belgjika! Punoi në ndërtim edhe në Mal të Zi

I afërmi i Ramazan Matajt, i cili u ekzekutua në Shkodër, tregon për mediat detaje nga jeta e të riut. Naim Mataj, djali i xhaxhait të babait të viktimës, thotë se i riu kishte jetuar në Belgjikë dhe sipas tij, nuk kanë konflikte me askënd.

> *"Ngjarjen e kemi marrë vesh në 06:30. S'ka pasur asnjë problem, ka jetuar në Dragoç. Më parë ka jetuar në Belgjikë, ka një vit e ca. Ka punuar edhe në Mal të Zi. S'ka shprehur asnjë shqetësim. Unë jo, por këtu njerëzit i kanë dëgjuar krismat. Apelin e kemi për policinë, nuk na la të shohim as kufomën. Ne s'kemi pasur konflikt me askënd, e kanë gjetur kalimtarët. Ka 3 fëmijë, dy djem e një vajzë. Kushtet i ka pasur të këqija, u rritën u futën në punë. Edhe vëllai tjetër është në Belgjikë", tha Naim Mataj.*

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:09

Atentati në Shkodër, makina e bërë 'shoshë' nga plumbat! I riu u qëllua nga të dyja anët e mjetit

Report Tv sjell pamje të tjera nga vendi i ngjarjes, ku ndodhi atentati në Dragoç të Shkodrës. Siç shihet edhe në këtë video, në mjeti dallohen shenjat e plumbave në makinën tip 'Benz' me të cilin po udhëtonte i riu.

Në drejtim të tij është qëlluar me breshëri kallashi nga të dyja krahët e makinës, çka do të thotë se janë të paktën 2 autorë qitës.

Shenjat e plumbave në makinën e viktimës

Sl.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:50

Del FOTO, ja kush është i riu që u ekzekutua me breshëri plumbash në Shkodër

Viktima Ramazan Mataj

Report Tv ka siguruar foton e të riut që u vra me breshëri plumbash në Dragoç të Shkodrës. I riu, Ramazan Mataj është qëlluar brenda në makinën e tij tip Benz. Dyshohet se ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e djeshme, 4 janar, por 33-vjeçari është gjetur i pajetë ditën e sotme nga banorë të zonës.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:43

I vranë të birin në Shkodër, flet babai: U rrit pa bukë e me vështirësi, s'ka pasur konflikte

Fatmir Mataj, babai i të riut të ekzekutuar në Dragoç të Shkodrës thotë se nuk di asnjë arsye përse u vra i biri. Ai deklaron se djali i tij Ramazan Mataj është rritur me shumë vështirësi, nuk ka qenë problematik dhe as di të ketë pasur konflikte me persona të tjerë.

> *"Nuk e di arsyen e vrasjes. Djali im nuk ka patur asnjë problem me persona të tjerë dhe asnjë konflikt. Ne nuk jemi në dijeni të asnjë konflikti. Djali im është rritur pa bukë dhe me shumë vështirësi. Nuk ka qenë aspak person problematik", u ka deklaruar babai policëve në vendin e ngjarjes.*

Një i afërm thotë se lajmin e trishtë e mësuan këtë mëngjes, 5 janar, ndërsa banorët e kishin gjetur të riun të vrarë brenda në makinë. Naim Mataj thotë se i riu nuk ka pasur asnjëherë probleme me të tjerë dhe se djali i tyre kishte jetuar për një kohë të gjatë në Belgjikë dhe kishte punuar gjithashtu në Mal të Zi.

> *"Ngjarjen e kemi marrë vesh në 06:30. S'ka pasur asnjë problem, ka jetuar në Dragoç. Më parë ka jetuar në Belgjikë, ka një vit e ca. Ka punuar edhe në Mal të Zi. S'ka shprehur asnjë shqetësim. Unë jo, por këtu njerëzit i kanë dëgjuar krismat. Apelin e kemi për policinë, nuk na la të shohim as kufomën. Ne s'kemi pasur konflikt me askënd, e kanë gjetur kalimtarët. Ka 3 fëmijë, dy djem e një vajzë. Kushtet i ka pasur të këqija, u rritën u futën në punë. Edhe vëllai tjetër është në Belgjikë", tha Naim Mataj.*

Naim Mataj ka theksuar se vëllai tjetër i viktimës jeton ende në Belgjikë, dhe familja e tij ka kaluar shumë vështirësi.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:38

Atentati në Shkodër, i riu u kthye para 1 viti nga Belgjika! Ja pista e hetimit

Report Tv mëson detaje të reja nga atentati në Shkodër. Burime bëjmë me dije se viktima, Ramzan Mataj ishte kthyer para 1 viti nga Belgjika.

Policia po heton nëse ka pasur konflikte në Belgjikë gjatë periudhës që ka jetuar atje.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:01

Atentati në Shkodër, Report Tv sjell pamjet nga vendi i ngjarjes! Ja 'Benz'-i me të cili udhëtonte i riu

Report Tv ka siguruar pamjet e para nga vendi ku ndodhi atentati në Dragoç të Shkodrës. Në pamje dallohet edhe mjeti tip 'Benz' me të cilin ka qenë duke lëvizur i riu, Ramazan Mataj, kur është qëlluar me armë zjarri.

Policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, siç shihet edhe në pamje, ku po mblidhen prova dhe po punohet për zbardhjen e plotë të saj.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:53

Atentati në Shkodër, reagon policia: 33-vjeçari u qëllua me armë në makinë

Policia e Shkodrës jep njoftimin për atentatin në Dragoç. I riu Ramzan Mataj është qëlluar nga jashtë makinës me armë.

> *"Rreth orës 07:15, në fshatin Dragoç, në rrugë, është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit tip Benz, me drejtues shtetasin R. M., 33 vjeç, banues në Dragoç, Shkodër, i cili ka humbur jetën.*
>
> *Në vendngjarje kanë shkuar shërbime të shumta të Policisë dhe Forca Kombëtare e Sigurisë, Njësia Shkodër.*
>
> *Është ngritur një grup i posaçëm hetimor dhe në drejtimin e Prokurorisë vijojnë intensivisht hetimet për zbardhjen e rrethanave dhe sigurimin e provave, me qëllim dokumentimin ligjor të rastit, identifikimin dhe kapjen e autorëve", njofton policia*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 08:37

Report Tv siguron emrin, ja kush është i riu që u vra sot në Shkodër

Viktima Ramazan Mataj

Shkodra u trondit nga një atentat me armë zjarri. Burime për Report Tv bëjnë me dije se është vrarë një i ri i identifikuar si Ramazan Mataj.

Ky i fundit është qëlluar me armë zjarri brenda në makinë. 33-vjeçari Mataj është nga Dragoçi, ndërsa ende nuk dihen rrethanat e kësaj ngjarjeje.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: atentat | vrasja e ramazan matajt | fatmir mataj | dragoc | Shkoder | Ramazan Mataj

Komento

Komente

Bosi: 05/01/2025 14:54

Me injoran m duken kta komentus qe thojn e kan vra kot se punote ndertim I shkreti, kur e di tan shkodra me ke rrite ky

Përgjigju

Qytetari: 05/01/2025 15:17

Po thuaje pra me ke rrinte se anonim je ketu ti e gjith ne tjert

emigranti: 05/01/2025 14:28

sikur u bene ndryshime ne ministri, drejtori dhe kryeministri thote se kemi arritur nivele te lart. ndoshta e ka fjalen per nivelin e krimit. vazhdojne ikin njerezit naten ...

Përgjigju

kiraskiras: 05/01/2025 14:13

Hajt se e zbulon policija e Shkoders....

Përgjigju

Jo jo: 05/01/2025 13:30

Mos flitni kot se gjynah. Viktima ka ken djal i mir i shkreti punetor , punote ne mal te zi ne ndertim . Nji qe merret me drog a me pun te pista nuk shkon punon me llac

Përgjigju

Haxhi: 05/01/2025 13:22

Ngushëllime familjes mataj jan shpi e nershme nuk merren me pun te kqija un i njoh mir zoti i lasht shnosh

Përgjigju

bajri lici: 05/01/2025 13:17

Po mor bab po noshta asht lodhe tu punu ne Mal te Zi e...kot se kan vra

Përgjigju

313: 05/01/2025 12:14

qe ka lidhje me masakren e tetorit kjo nuk v do mend. ndoshta ky ka qen shofer ose kallauz ose vezhgues i viktimave.

Përgjigju

Per: 05/01/2025 12:57

Sigurisht qe ka lidhje se ramazani esht shok i ngusht me haton dhe asmerin

Altin polici: 05/01/2025 11:07

Dihej qe mas vrasjes se hamzas dhe arlindit, shkodra kishte per t vlu. E gjith kjo per faj te shtetit

Përgjigju

Futja kot: 05/01/2025 12:35

Ca ka lidhje kjo pune mos flitni marrina

AltinTop: 05/01/2025 10:47

Policia e mori vesh nga banoret se mbreme ka pasur bresheri kallashi…hajde shteti hajde.

Përgjigju

WTF: 05/01/2025 10:26

I varfer me Mercedes dhe ore Cartier! Beni gazetari dhe pyesni si i ka bere parate ky dhe motivi del i qarte.

Përgjigju

O shoku: 05/01/2025 11:40

Makina 6 mij euro ben , ora fallso si shumica shiptareve 30 mij lek

Agjenti: 05/01/2025 10:23

Mos beni gola o njerez se u shuat me njeri tjetrin

Përgjigju

Emi: 05/01/2025 10:19

Shqipnija ashte ba ven varrezash.

Përgjigju

Baba: 05/01/2025 09:00

Me duket se u zgju fantazma

Përgjigju

Gjyshi: 05/01/2025 10:43

Ik more idiot! Fantazma jote akoma se ka mbledhur veten se shpetoi kot.

Talibanet: 05/01/2025 08:21

Keta jane ber me keq se talibanet vetem vrasje perdite ndodhin ne Shkoder

Përgjigju

Ik: 05/01/2025 08:35

O k

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:

A jeni dakord me vendimin e gjykatës për detyrim paraqitje të Berishës?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Humbi kontrollin e makinës dhe përplasi për vdekje xhaxha e nip! Arrestohet 21-vjeçari në Shkodër

4 Janar, 14:23

Reshje të dendura bore në Theth, Tamarë dhe në 'Rrugën e Kombit'! Akset të hapura, nga tuneli në Morinë qarkullimi me goma dimërore (VIDEO)

4 Janar, 09:28

Lëpusha mbulohet nga dëbora, tërheq vizitorë të shumtë (FOTO)

3 Janar, 18:15

Shkodër/ Aksident i rëndë pranë fshatit Mjedë! Makina del nga rruga, përplas për vdekje 2 këmbësorë! Viktimat, xhaxha e nip (VIDEO+EMRAT)

3 Janar, 17:48



Atentati i dështuar me breshëri kallashi ndaj dy shokëve në Berat, Policia shpall në kërkim 2 vëllezërit durrsakë

3 Janar, 14:15

Misteri i atentatit të dështuar në Shkodër, breshëri ndaj makinës së parkuar, pronari i saj në burg për dhunë në familje

Ergys Kavaja

3 Janar, 12:10

Shkodër/ Grabiti me armë dy vëllezër dhe më pas i shantazhoi që t'i jepnin 20 mijë lekë, arrestohet 32-vjeçari! Momenti i prangosjes (VIDEO+EMRI)

3 Janar, 10:24

Digjet makina në aksin Lezhë-Vau Dejës, nuk ka të lënduar

2 Janar, 22:08

Shkodër/ Të shtëna me armë zjarri në lagjen Rus, qëllohet 4 herë drejt një makine të parkuar! Autori lëvizte me motor pa targa, policia në vendngjarje

2 Janar, 20:37

'Betlehemi i gjallë' vendoset në skenë në Hajmel, shfaqja e ritualit të Krishtlindjes tërheq qindra vizitorë (VIDEO)

Elvis Hila

2 Janar, 19:28

Shqipëri-Mali i Zi/ Fluks i lartë në pikën kufitare të Muriqanit, rreth 11 mijë persona në hyrje-dalje për dy ditë! Rriten sportelet (VIDEO)

Ergys Kavaja

2 Janar, 13:37



Shkodër/ Qytetarët presin në shesh ndërrimin e viteve me koncert dhe fishekzjarre, edhe kryebashkiaku Beci prezent

1 Janar, 00:18

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje